Kodulli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr 20396 Prot., Lezhë, me, 16 10 2026

PROJEKT -VENDIM

Nr _____, Datë _____

PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE

Mbështetur në

- **Ligjin nr.139/2015** "Për Vetëqeverisjen Vendore",i ndryshuar, neni 9, pika1/1.3, germa "b", neni 35, pika 4, neni 54, germa "f"
- **Ligj Nr 9632** datë 30 10 2006 - Per sistemin e taksave vendore - i ndryshuar
- **Ligji nr.122/2020** date 15.10.2020 i ndryshuar, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Neni 5, germa "b", "c" dhe "ç", neni 7, neni 9, etj në vijim,
- **Ligjin nr.9920**, datë 19.05.2008, i ndryshuar AN nr.36, date 24.12.2021, "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore",
- **Ligjin nr.115/2014,** i ndryshuar "Për Ndarjen Administrativo Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë",i ndrysh
- **Ligjin nr.9975**, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" i ndryshuar,
- **Ligjin nr.9723** "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar,
- **Ligjin nr.107/2014**, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar,
- **Ligjin nr.8378,** datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- **VKM nr.132,** datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtëshme Ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënat për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar me VKM nr.168, datë 27.03.2019, VKM nr.144, datë 13.02.2020 dhe VKM 457 date 26.07.2023.

- **VKM nr.408**, datë13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar me VKM nr. 672, datë 29.07.2015; VKM nr. 1043, datë 16.12.2015; VKM nr. 271, datë 6.4.2016; VKM nr. 231, datë 21.3.2017; VKM nr. 355, datë 19.4.2017, VKM nr. 693, datë 2.10.2019; VKM nr. 796, datë 11.12.2019; VKM nr. 457, datë 29.6.2022.
- **VKM Nr.171**, datë 27.3.2019 "Për miratimin e rregullores "për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", ndryshuar me VKM nr. 424, datë 27.05.2020; nr. 1172, datë 24.12.2020; nr. 827, datë 24.12.2021; nr. 659, datë 10.10.2022.
- **VKM nr.85**, datë 08.02.2017 "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor" i ndryshuar.
- **VKM nr.970,** datë 02.02.2015 "Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar.
- **Udhëzimin nr.15**, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar.
- **Udhëzimin nr.5627**, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar.
- **Udhëzim nr.17** date 20.06.2022 "Per percaktimin e uniformitetit minimal te standadeve proceduriale per mbledhjen e detyrimeve te taksave e tarifave vendore".
- **Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit të antarëve ;**

VENDOSI

I. **Të bëjë ndarjen administrative territoriale të Bashkisë Lezhë, për efekt të diferencimit në ofrimin e cilësisë së shërbimeve ndaj kategorisë së taksapaguesve, me qëllim bashkërendimin dhe përafrimin e kostos së tyre me nivelin e aplikimit të tarifave vendore, në dy zona si më poshtë :**

a. Zona A me përbërje: Nj.A. Lezhë dhe Nj.A. Shëngjin.
b. Zona B, me përbërje: Nj.A. Kolsh, Nj.A. Zejmen dhe Nj.A. Shënkoll, Nj.A.Balldre, Nj.A. Dajç, Nj.A. Blinisht, Nj.A. Kallmet dhe Nj.A. Ungrej.

I.1. Autostrada Lezhë-Milot, duke filluar nga kryqëzimi pranë Urës së Re të qytetit Lezhë e deri tek Ura e lumit Mat dhe Austostrada Lezhë-Shkodër, duke filluar nga kryqëzimi pranë Urës së Re të qytetit Lezhë e deri tek ndarja territoriale me Bashkinë Shkodër, në të dy krahët e rrugëve, me distancë 100(njëqind) metër nga rruga kryesore për sejcilin krah të rrugës, pamvarësisht Njësive Administrative, që këto segmente rruge i përkasin, vetëm për kategorinë e taksapaguesve "Biznes", do të tarifohen si pjesë përbërëse e Zonës "**A**".

II. **Miratimin, për të gjithë kategoritë e taksapaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike dhe administrative, të ofruara në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë, nivelin e taksave dhe tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, afatet e pagesës, përjashtimet e lehtësirat fiskale për çdo zë, sipas**

kategorive përfituese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre, të drejtën e ankimimit për çdo vlerësim /faturim /gjobë, arsyen e vendosjes së penaliteteve / gjobave për kundravajtjet e shkaktuara nga taksapaguesit, nivelin e tyre për çdo kundravajtje si dhe strukturat e ngarkuara për vendosjen dhe vjeljen e tyre, si më poshtë vijon :

A. TAKSAT VENDORE

Në zërin "Taksa Vendore", konform ligjit nr.9632, datë 30.10.2006"Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, përfshihen llojet e tyre si më poshtë :

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.
2. Taksa mbi Pasurinë e Paluejtëshme.
   a. Taksa mbi Ndërtesat,
   b. Taksa mbi Tokën Bujqësore
   c. Taksa mbi Truallin.
3. Taksa e Fjetjes në Hotel.
4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.
5. Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluejtëshme.
6. Taksa e Tabelës.
7. Taksa të Përkohshme.

A.1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

A.1.1. Përkufizimi

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, nuk i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

A.1.2. Strukturat përgjegjëse

Është Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Për këtë shërbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Lezhë përfiton një komision prej 1(një) % të të ardhurave të mbledhura.

A.2. Taksa mbi pasurinë e paluajtëshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.
Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.
Në taksat mbi pasurinë e paluajtëshme përfshihen:

a) **Taksa mbi Ndërtesën**
b) **Taksa mbi Tokën Bujqësore**
c) **Taksa mbi Truallin**

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.
Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë Lezhë, e cila më pas ka të drejtë, që të ngrejë një komision/grup pune, nga stafi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ose edhe jashtë kësaj Drejtorie, i cili bën matjen faktike në terren të sipërfaqes përkatëse dhe më pas ky akt konstatimi i kalon për vlerësim Sektorit të Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
Te gjithe Taksapaguesit familjare qe kane detyrimin per pagesen e takses se pasurise te percaktuar te tille sipas ligjit, bejne vetedeklarimin e pasurise prane sporteleve te Ujesjelles Kanalizime Lezhe dhe prane Njesive Administrative ku banojne brenda dates 30.03.2027 sipas Formularit te Vetedeklarimit nr 1 bashkangjitur paketes fiskale.

Mosdorezimi i Formularit te Vetedeklarimit ne afat penalizon cdo taksapagues familjar me 10 000 leke gjobe.

Te gjithe taksapaguesit Pronare Posedues te prones per qellime ekonomike dhe te gjithe taksapaguesit Biznes, bejne vetedeklarimin e prones se tyre prane Drejtorise se taksave dhe Tarifave Vendore (dorazi, me shkrese, nepermjert account ne sistemin e taksave apo dhe mail taksat@lezha.gov.al), nepermjet Formularit te Vetedeklarimit nr 1 bashkangjitur paketes fiskale brenda dates 31.01.2027

Mosdorezimi ne afat i Formularit te Vetedeklarimit mbi pasurine penalizon cdo taksapgues Pronare Posedues apo Biznes me 20 000 leke gjobe.

Nese gjate verifikimeve nga specialistet e terrenit prane Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore konstatohen prona te deklaruara fiktivisht me qellim shmangjen e pageses se takses

se prones, per secilen Takse Pasurie behet rivleresim nga specialistet e Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore per vleren e munguar, që nga data e ushtrimit të aktivitetit sipas adresave të deklaruara në QKB;

-Per Pronaret Posedues prej dates qe jane pajisur me Certifikate Regjistrimi Hipotekore apo dokument tjeter pronesie.
-Per Biznesin prej dates kur behet verifikimi nga specialistet e Terrenit.

A.2.a.Taksa mbi Ndërtesën

A.2.a.1. Përkufizimi

Ndërtesë quhet objekti / objektet e ndërtuara mbi / nën siperfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesen, sipas përcaktimit të dhënë në ligj. Bazuar në përkufizimin e dhënë nga metodologjia për taksën e ndërtesës, objekt taksimi do të jetë çdo ndërtim, që përfaqëson një strukture ndërtimore dhe me natyrë të qëndrueshme. Me ndërtim me natyrë të qëndrueshme kuptohet një strukturë e lidhur me tokën, për realizimin e së cilës nevojitet procesi i zënies së një siperfaqeje toke për t'u ndërtuar, që nga elementët e thjeshtë të sistemimit, siç janë hedhja e themeleve, deri në ndërtimin përfundimtar me ngritjen e shtyllave, kolonave apo trarëve.

A.2.a.2. Baza e Taksës

Është sipërfaqja në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Dokumentet, që vërtetojnë pronësinë janë Çertifikata e pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave, Vendimi i privatizimit, etj, dokumentet konform legjislacionit në fuqi.

A.2.a.3. Niveli i Taksës

Niveli i takës është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli i taksës
1	Ndërtesa banimi	Lekë/m^2 sipërfaqe shfrytzuar	**20**
2	Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra.		**119**
3	Ndërtesa me sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat, që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura		**39.2**

4	Ndërtesa për parkim :		
a	*Të Mbuluar*		**65**
b	Ndërtesa me sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbolli, minifutbolli, basketbolli, volejbolli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë.		**33.5**
5	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësorë dhe blegtorale.		**23.5**
6	Për ndërtesat në proces ndërtimi, të cilat kanë tejkaluar afatin e lejes së ndërtimit.		**30%** e zërit përkatës të taksës

A.2.a.4. Kategorizimi i ndërtesave;

1.Ndërtesa banimi konsiderohen ato ndërtesa, të cilat përdoren nga qytetarët vetëm për qëllime banimi dhe jo për qëllime fitimprurëse si dhe ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.

2.Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra, konsiderohen ato ndërtesa, të cilat shfrytëzohen nga pronarët e tyre për qëllime fitimprurëse, që ushtrojnë aktivitete private në fushën :

a) e tregtisë, si tregtim artikuj insdutrial dhe ushqimor, fruta perime, etj te ngjashme me to.

b) e shërbimeve, si Agjenci bankare, këmbimi valute, doganore, hoteleri-turizëm, turizëm familjar, palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, qendra shitje karburanti, farmaci, klinika, spitale, agjenci sigurimesh, agjenci transporti, autoservise, autoshkolla, Lavanteri, pastrim kimik, rojet civile, salla lojra të ndryshme, marangoz, riparime të ndryshme, parukeri / floktore, rrobaqepësi,etj te ngjashme me to.

c) e profesioneve të lira, si avokat, noter, studio konsulence, ekonomist, inxhinier, mjek, fondacione të ndryshme, etj te ngjashme me to.

3.Ndërtesa për prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale dhe ushqimore, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat, përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letra, kartoni, shtypshkronjë, tulla, tjegulla, prodhime ushqimore, furrë bukë, prodhim konfeksione, prodhim dhe përpunim vajra, karburante, etj, prodhim dhe përpunim produkte farmaceutike dhe objektet e tjera të ngjashme me to.

4. Ndërtesa për parkim :

a) të mbuluar, konsiderohen ato ndërtesa, që përdoren për ushtrimin e aktivitetit si shërbim parkimi për të tretët, në ambjente të mbyllura ose nëntokësore.

b) të hapur konsiderohen ato ndërtesa, që përdoren për ushtrimin e aktivitetit si shërbim parkimi për të tretët, në ambjente të hapura.

5.Ndërtesa, që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësorë dhe blegtorale, konsiderohen ato ndërtesa si stalla për bagëti, magazinat e ruajtjes së produkteve bujqësore e blegtorale, bimëve medicinale, etj te ngjashme me to.

A.2.a.5. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve janë:

a. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë "biznes", strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila e kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës dhe kategorive, në tabelën e cituar më lart. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë"Familjarë", që kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, ndërsa për ato familjarë, që nuk kanë kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, atëherë strukturat përgjegjëse janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për qytetin e Lezhës, dhe Njësitë Administrative, sipas vendndodhjes së Ndërtesës.

A.2.a.6. Në rastet e mungesës ose mos paraqitjes së dokumentacionit për pronësinë mbi ndërtesat:

a. Kategoria "Familjarë", që kanë kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, kanë detyrimin të dërgojnë tek ky Institucion çertifikatën e pronësisë së banesës, mbi bazën e të cilës do bëhet faturimi për taksën mbi ndërtesën. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të sipërcituar, atëherë do faturohet për një sipërfaqe banese prej 100 m^2, për çdo kryefamiljar, që ka kontratë me Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë.
b. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës mbi ndërtesat do t'i referohen VKM nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtëshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar.

A.2.a.7. Afatet e pagesës së taksës :

a. Për kategorinë "Biznes", ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor , është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
b. Për kategorinë "Familjarë", Taksa e ndërtesës do të paguhet me 12 këste të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, kurse për familjarët, që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për banesat brenda territorit të qytetit të Lezhës dhe nga Njësitë Administrative, sipas vendndodhjes së Ndërtesës.

A.2.a.8.Përjashtimet nga pagesa e taksës mbi ndërtesat janë për kategoritë e mëposhtëme :

a. Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jo fitimprurese.
b. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
c. Banesat sociale në pronësi të Bashkive.

d. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qirramarësit me qera të pa liberalizuara,
e. Ndërtesat, që perdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
f. Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, "status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
g. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie / pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
h. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve, që trajtohen me ndihmë ekonomike;
i. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
j. Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale.

Për të përfituar këto lehtësira fiskale kategoria "Familjarë", duhet të dorëzojnë tek Strukturat Përgjegjëse dhe tek Agjenti Tatimor i caktuar, që është Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, dokumentat e mëposhtëm:

a. Çertifikatën familjare,
b. Librezen e Pensionit.
c. Dokumentacion tjeter qe verteton kushtet e mesiperme.
d. Vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike.

A.2.b.Taksa mbi Tokën Bujqësore.

A.2.b.1. Përkufizimi :

Tokë Bujqësore është ajo e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

A.2.b.2. Baza e taksës:

Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

A.2.b.3. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Niveli i taksës paraqitet si më poshtë:

Nr	Kategoritë e tokës	Njësia	Niveli i taksës
1	I	Lekë / Ha / Vit	5,600
2	II		4,900
3	III		4,200
4	IV		3,600
5	V		3,000
6	VI		2,400
7	VII-X		1,800

A.2.b.4. Strukturat përgjegjëse për vjeljen :

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për kategorinë e taksapaguesve "Biznes", është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë, ndërsa për kategorinë "Familjarë", është Njësia Administrative përkatëse sipas vendndodhjes së pasurisë "Tokë Bujqësore". Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e katëgorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Ngarkohet Drejtoria e Kadastres dhe Administrimit të Aseteve, të saktësojë Aktin e marrjes se tokës në pronësi (AMTP), sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herë pas hershme dhe ia percjell këtë informacion Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësive Administrative përkatëse sipas vendndodhjes së pasurisë, për llogaritjen e detyrimit.

A.2.b.5. Afatet e pagesës : Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje këst. Afati i pagesës eshte data 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit te pronave, sqarojmë se për personat,që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyres së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive, sipas ligjeve nëfuqi.

A.2.b.6. Përjashtime nga pagesa e taksës: Përjashtohen nga pagesa e taksës mbi tokën bujqësore, ato që mbillen me kultura dru frutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

A.2.c.Taksa mbi Truallin

A.2.c.1. Baza e taksës:

Është sipërfaqja e truallit në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Siperfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve, që e vërtetojnë atë. Taksa mbi truallin, nuk do të aplikohet për kategorinë familjarë, në ato ndërtesa banimi, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë pallate banimi.

A.2.c.2. Në rast të mungeses së dokumentacionit të pronësisë:

Përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të siperfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë ku ndodhet trualli. Pas deklarimit të bërë nga ana e subjektit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka detyrimin të verifikojë në terren, me grupet e punës të sektorit të kontrollit, saktësinë e vetëdeklarimit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklarimit. Në rastet e konstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjeketit, atëherë do zbatohen procedurat e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 116.

A.2.c.3. Niveli i taksës:

Është në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, paguhet në buxhetin e Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Nr	Kategorizimi sipas qëllimit të përdorimit	Njësia	Niveli i taksës
1	**Për qëllime banimi nga individët**	Lekë /m^2/ Vit	**0.56**
2	**Për qëllime biznesi**		**20**

A.2.c.4. Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor e vitit korent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

A.2.c.5. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës mbi Truallin, për kategorinë e taksapaguesve Biznes, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë, ndërsa për kategorinë "Familjarë", është Njësia Administrative përkatëse sipas vendndodhjes së pasurisë "Truall". Ngarkohet Drejtoria e Kadastres dhe Administrimit të Aseteve, të saktësojë Aktin e marrjes se tokës në pronësi (AMTP), sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme dhe ia percjell këtë informacion Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësive Administrative përkatëse sipas vendndodhjes së pasurisë, për llogaritjen e detyrimit.

A.3. Taksa e Fjetjes në Hotel

A.3.1. Përkufizimi :

Me Hotel, kuptohet çdo veprimtari,e cila jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet Hotel, Motel, Stabiliment Turistik, Pension, Shtëpi Pritje, Turizëm Familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret për këtë qëllim.

A.3.2. Baza e taksës :

Si bazë e taksës konsiderohet numri i netëve të qëndruara në hotel për çdo person.

A.3.3. Niveli i taksës :

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Këshilli i Bashkisë, për netë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Kjo taksë bazohet në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Nr	Kategoritë e njësive akomoduese hotelerike	Njësia	Niveli i taksës
1	Hotel me 4 & 5 Yje	Lekë /natë qëndrimi / Person	**175**
2	Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.		**70**

A.3.4. Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën i takon klientit, që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli përllogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit, në të cilën shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të shënohet vlera e taksës. Subjekti ka detyrim ligjor të kryejë pagesën për taksën e fjetjes në hotel, brenda datës 10 të muajit pasardhës. Kjo pagesë duhet të jetë e barazvlefshme me të dhënat e mbajtura në "Regjistrin e Fjetjes" në hotel, të cilat paraqiten për konfirmim tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, çdo fund muaji për muajin paraardhës. "Regjistri i Fjetjes" i çdo subjekti, që ushtron aktivitetin në fushën e shërbimit të hotelerisë, duhet të jetë i sekretuar dhe i çertifikuar nga Bashkia Lezhë, sipas formatit të miratuar me VKB nr.123, datë 26.12.2019 "Për miratimin e modelit të Regjistrit të Fjetjes në Hotele", i ndryshuar me VKB nr.2, datë 28.01.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKB nr.123, datë 26.12.2019 Për miratimin e modelit të Regjistrit të Fjetjes në Hotele".

A.3.5. Vlerësimi alternativ .

Dorëzimi i librit të fjetjes bëhet nëpermjet dorëzimit dorazi pranë zyrës së Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ose në mënyrë digitale nëpërmjet sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore, cdo datë 5 të muajit paraardhës.

A.3.5.1. Në rastet kur, "Regjistri i Fjetjes" nuk paraqitet fare, atëherë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka të drejtë të bëjë vlerësim alternativ, duke marrë për bazë numrin e dhomave, që subjekti ka në shfrytëzim të aktivitetit si Hoteleri, me një numër minimal prej 2 (dy) personash për çdo dhomë, me bazë ditore për 90 dite kalendarike, që subjekti është aktiv në sistemin tatimor.

A.3.5.2. Në rastet kur, "Regjistri i Fjetjes" paraqitet me fletë të dëmtuara, të korigjuara apo jo në përputhje me numrin serial të marrë në dorëzim, atëherë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka të drejtë të bëjë vlerësim alternativ, duke marrë për bazë numrin e dhomave, që subjekti ka në shfrytëzim të aktivitetit si Hoteleri, me një numër minimal prej 2 (dy) personash për çdo dhomë, me bazë ditore 90 dite kalendarike, që fletët e regjistrit janë të dëmtuara, të korigjuara apo jo në përputhje me numrin serial të marrë në dorëzim.

A.3.5.3. Në rastet kur, subjekti paraqet "Regjistrin e Fjetjes" me të dhëna, të cilat nuk përputhen me të dhënat, që konstatohen në rastet e ushtrimit të kontrolleve në terren, për të cilat është mbajtur akti i konstatimit dhe është konstatuar se janë gjetur klientë, që i është ofruar shërbimi hoteleri, por ato nuk figurojnë tëregjistruar në bllokun "Regjistër i Fjetjes", atëherë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore do të bëhet rivlerësim, duke marrë për bazë numrin e personave të gjetur të pa regjistruar, referuar Aktit të Konstatimit, me bazë ditore, për një periudhë 90 dite kalendarike të mëparshme, e cila mbaron në datën e mbajtjes së aktit të konstatimit.

A.3.6. Afati i pagesës :
Pagesa kryhet brënda dates 5 të muajit pasardhës.

A.3.7. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :
Është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

A.4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

A.4.1. Niveli i taksës:

Sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë :

Nr	Kategorizimi i Ndertimeve dhe Investimeve	Njësia	Niveli i takses
1	a). Ndertesa të destinuara për qellime banimi apo për njësi tregtimi dhe sherbimi, për të cilat kërkohet Leje Ndërtimi .	Në % të cmimit të shitjes për m2 ndertim	6%
	b). Ndertime zevendesuese për qellime banimi, të kushtezuara për tu ndertuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese, për të cilat kërkohet Leje Ndërtimi .		

	c). Ndertimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit		
2	a). Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	Në % të vlerës së investimit	3%
	a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin.		1%
	b). Për projekte të infrastruktures, për ndertimin e rrugeve kombetare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndertimit të infrastruktures në energji, përfshire makineritë dhe pajisjet për këto projekte. Por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastruktures së demtuar, kur kjo kosto nuk është përfshire në preventivin e investimit.		0.1%
	c). Për Leje të Infrastruktures, të porteve, të areoporteve, të ndertimit të infrastruktures në energji jopublike.		3 %
	d). Për ndertesat, të cilat janë në proces legalizimi.		0.5%
	e). Për ndertesat, që destinohen për qellime banimi në zonat malore		2 %
3	a) Për lejen e strukturave të përkohshme për qellime biznesi, sherbim, tregeti	leke/m^2	2 000
	b) Për punime që kërkojnë Deklaratë Paraprake Punimesh, por jo për qellime bujqësore.	Të vleres së investimi por jo më pak se 10.000 Lekë.	2 %
	c) Për punime që kërkojnë Deklaratë Paraprakë Punimesh për qellime bujqësore, si sera ambjente ndihmese jo prodhuese, etj.	Për m^2 strukture	50
	ç) Për punime që kërkojnë Deklaratë Paraprake Punimesh, për prodhim, magazim.	Të vleres së investimi por jo më pak se 10.000 Lekë	2 %
	d) Për punime që kërkojnë Deklaratë Paraprake Punimesh për qellime të reklamimit si tabela njoftuese apo reklamuese .	Të vlerës së investimit, por jo më pak se 10.000 Lekë'	0.5 %
	e) Për platforma të përkohshme që kërkojnë Deklaratë Paraprake Punimesh.	Për m^2 strukture	400

Baza e taksës (për pikën 1): Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e

vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme Ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënat për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".

Baza e taksës (për piken 2): Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Mënyra e pagesës: Detyrimi për pagesen e takses i takon investitorit (zhvilluesit).

Afati i pagesës : Të gjitha subjektet ndertuese do të terheqin lejen e ndertimit pranë Bashkisë Lezhë, vetem pasi të kenë kryer pagesen e Takses së Ndikimit në Infrastrukture si dhe vertetimin e lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore se nuk kane detyrime tatimore të palikuiduara ndaj Bashkisë Lezhë deri në daten e aplikimit për leje.

Stukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:
Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe lëshimin për pagesen e takses së ndikimit në infrastrukture nga ndertimet e reja është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Lezhë.

Përjashtimet nga pagesa e takses:
Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".
Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si *"agroturizëm"*, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.

A.5 Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluejtëshme.

A.5.1. Baza e taksës:
Është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

A.5.2. Niveli i Taksës
Është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli i taksës

			Për Njësinë Lezhë, Shengjin e Shënkollë	Për Njësitë e tjera
1	Ndërtesa banimi	Lekë/m^2	300	100
2	Ndërtesa për tregëti e shërbime		700	300
3	Ndërtesa të tjera		500	200

A.5.3. Mënyra e pagesës :
Niveli i taksës caktohet në lekë/m^2 të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

A.5.4. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:
Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Drejtoria Vendore e ASHK Lezhe, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. Ngarkohet Drejtoria e Finances pranë Bashkisë Lezhë, që të bëje rakordimet me Drejtorine Vendore te ASHK Lezhë, për planifikimin e të ardhurave.

A.5.5. Përjashtime:
Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:
A.5.5.1.Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
A.5.5.2.Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat";
A.5.5.3.Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
A.5.5.3.1.Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
A.5.5.3.2.Bashkësitë fetare ose Organizatat Jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën, që i takon agjentit të taksave.
A.5.5.3.3.Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

A.6. Taksa e Tabelës

A.6.3. Niveli i Taksës
Është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategorizimi i Tabelave	Njësia	Niveli i taksës	
			Zona A	Zona B

1	**Tabela për qëllime identifikimi te veprimtarise se subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)**			
a	**Deri ne 2 m²**			**0**
b	**Mbi 2 m² deri ne 10 m²**			
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m²/vit	**2.000**	**1.000**
	Me ndriçim të thjeshtë		**5.500**	**3.000**
	Elektronike		**7.500**	**5.000**
c	**Mbi 10 m² deri ne 20 m²**			
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m²/vit	**1.800**	**900**
	Me ndriçim të thjeshtë		**5.000**	**2.700**
	Elektronike		**6.750**	**4.500**
ç	**Mbi 20 m² deri ne 40 m²**			
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m²/vit	**1.620**	**810**
	Me ndriçim të thjeshtë		**4.500**	**2.450**
	Elektronike		**6.100**	**4.000**
d	**Mbi 40 m²**			
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m²/vit	**1.460**	**730**
	Me ndriçim të thjeshtë		**4.000**	**2.200**
	Elektronike		**5.500**	**3.600**
2	**Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim**			
	Tabela identifikuese	Lekë/m²/vit	**42**	**21**
3	**Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, deri në tavanin maksimal 35 m².**			
a	E thjeshtë (me/pa ndriçim)	Lekë /m²/vit	**10.000**	**3.000**
b	Elektronike		**25.000**	**18.000**
4	**Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj**			
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë /m²/ditë	**350**	**170**

A.6.4. Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi tabelën është vjetor. Për të gjitha kategoritë, ky detyrim paguhet me 1(një) këst. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga Bashkia.

A.6.5. Afati i pagesës

Për taksën mbi tabelat është sipas kategorive :

A.6.5.1.Për kategorine 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 30 qershor,

detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.

A.6.5.2.Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë.

A.6.5.3.Për kategorinë e 3-të dhe të 4-t, detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë dhe paguhet menjëherë me marrjen e lejes.

A.6.5.4. Pagesa kryhet paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar kryerja e pagesës nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas kontratës së firmosur nga palët.

A.6.6. Dhënia e Lejes për vendosje Tabele për Qëllime Reklamimi

Në të gjitha rastet e kërkesës për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime identifikimi dhe reklamimi, të thjeshta dhe elektronike referuar pikave 1, 2, 3 dhe 4 në tabelën e mësipërnme, subjekti duhet t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në Bashkinë Lezhë, me kërkesë për t'u paisur me Leje. Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi, nëse kjo sipërfaqe, që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti, është pjesë e hapësirave publike të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban lidhur me sipërfaqen e tabelës, që do përdoret për qëllime reklamimi, të thjeshta apo elektronike, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të taksës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar. Në fund fare, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes subjektit.

A.6.7. Monitorimi i zbatimit të kontratës

Nëse gjatë ushtrimit të kontrolleve të përditshme në terren, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohen raste të shfrytëzimit të hapësirave publike për vendosje të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike, mbi sipërfaqen e caktuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë si dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike për qëllime të tilla, pa Leje dhe pa Kontratë, të lidhur me Bashkinë Lezhë, në të dyja rastet, inspektorët e kontrollit dhe verifikimit në terren, kane detyrim matjen e saktë të sipërfaqes së tabelës dhe mbajtjen e akt konstatimit për çdo rast. Ky akt konstatimi, i mbajtur nga inspektorët e Sektorit të kontrollit dhe Verifikimit në terren, i kalon për vlerësim tatimor, Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me nivelin e taksave të cituar në tabelën e mësipërme, për sa kohë, që ajo sipërfaqe vazhdon të shfrytëzohet nga subjekti. Krahas kësaj procedure, hartohet dhe shkresa përkatëse për informacion për shfrytëzim të sipërfaqes së hapësirës publike, pa Lejen përkatëse nga Bashkia, për Policinë e Bashkisë dhe IVMT, të cilat ndjekin procedurat e tjera, konform ligjit.

A.6.8. Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës

Strukturë përgjegjëse për vjeljen e taksësmbi tabelën, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.

A.7. Taksa të Përkohshme

A.7.1. Përkufizimi :

Taksa e Përkohshme për Arsimin do të aplikohet për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Lezhë. Të ardhurat nga kjo taksë do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me financimin e shërbimit të rojeve në institucionet arsimore publike.

A.7.2. Afati i pagesës

Kjo taksë do të faturohet 1 (një) herë në vit dhe do të likuidohet sipas afateve të përcaktuara për taksat dhe tarifat vendore vjetore.

A.7.3. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Struktura përgjegjëse për administrimin, faturimin dhe vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

A.7.4. Niveli i taksës :

Detyrimi për taksën e Perkohshme në Arsim do behet ne baze të kategorisë xhirove së bizneseve të percaktuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë. Kategoritë do jenë si meposhtë :

Nr	Kategorizimi	Njësia	Niveli i taksës
1	**Biznes i Madh (mbi 30 mil)**	Lekë / Vit	**7.000**
2	**Biznes i Mesem (8-30 mil)**		**2.000**
3	**Biznes i Vogel (0-8 mil)**		**1.000**

B. TARIFAT VENDORE

Në zërin "Tarifa Vendore", konform ligjit për Sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, përfshihen llojet e tyre si më poshtë :

B.1. Tarifat e Shërbimeve Publike

Në Tarifat e Shërbimeve Publike përfshihen :

a. **Tarifa për Pastrimin**
b. **Tarifa për Gjelbërimin**
c. **Tarifa për Ndriçimin**
d. **Tarifa për Dekorin**
e. **Tarifa për Mirëmbajtjen e Varrezave Publike**

B.1.2. Përkufizimi

B.1.2.1.Tarifës së Shërbimeve Publike ku përfshihen tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit, i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë si dhe që, ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë dhe Njësive të saj Administrative. Pjesë e tarifave të Shërbimeve Publike janë edhe Shërbimet e

Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, shërbime të cilat, i përfitojnë dhe faturohen vetëm kategoria e taksapaguesve familjarë të zonës, që marrin atë shërbim.

B.1.2.2. Për kategorinë e taksapaguesve "Familjarë" tarifat do aplikohen sipas ndarjes zonale, ndërsa për taksapaguesit e kategorisë "Biznes", tarifat do aplikohen sipas ndarjes zonale dhe sipas nivelit të xhiros vjetore, që ato realizojnë, duke marrë për bazë informacionin zyrtar të marrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar një vit më parë, ndërsapër kategorinë e taksapaguesve "Institucione", tarifat do aplikohen sipas sipërfaqes në metër katror të objektit / ndërtesës, pamvarësisht se në cilën zonë e ushtrojnë aktivitetin.

B.1.3. Kategoritë e përfituesve të shërbimit dhe ato të faturimit.

Përfitues të Shërbimeve Publike, që tarifohen për zërat e tarifave përkatëse, janë kategoritë:

a. "**Familjarë**", për çdo Kryefamiljar
b. "**Biznes**", për çdo seli dhe për çdo adresë sekondare, të deklaruar në QKB ose të identifikuar nga kontrollet në terren.
c. "**Institucione Shtetërore**", për çdo vendndodhje të ushtrimit të aktivitetit.

B.1.3.a. Kategoria e taksapaguesve "Familjarë",

Me familjarë kuptohet çdo kryefamiljar, qëështë i regjstruar në regjistrin e Gjendjes Civile të Bashkisë Lezhë, si i tillë.

B.1.3.a.1. Baza e tarifës, është llogaritur mbi koston e shërbimeve të ofruara në të gjithë territorin, i cili është nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

B.1.3.a.2. Niveli i Tarifës

Kategoritë, nën kategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura në tabelën si më poshtë:

Nr	Emertimi i Tarifave	Njësia		
			A	B
B.1.	Tarifat e Shërbimeve Publike (total)			
			3.200	1.650
a	Tarifa e Pastrimit	Leke / Krye Familjar / vit	1.700	1.100
b	Tarifa e Gjelbërimit		500	0
c	Tarifa e Ndriçimit		550	350
d	Tarifa e Dekorit		150	0
e	Tarifa e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike		300	200

B.1.3.a.3.Mënyra e pagesës:

Për kategorinë e taksapaguesve "Familjarë", Tarifat e Shërbimeve Publike, ku përfshihen Tarifat e Pastrimit, Ndriçimit, Gjelbërimit, Dekorit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, do të paguhen me 12 këste të barabarta, referuar tabelës së mësipërme, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm për familjarët, që kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, ndërsa për familjarët, që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A., Tarifat e Shërbimeve Publike do të paguhen, po me

12 këste të barabarta, pranë Njësisë Administrative ku ato banojnë.

B.1.3.a.4. Afati i pagesës

Për familjarët, që kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, pagesa kryhet brenda afatit të cituar në faturën e ujit të pijshëm, të dalë nga ai Institucion, ndërsa për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, afati i pagesës është brenda datës 30, të çdo muaji, të vitit korent, për muajin paraardhës. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj. Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën çdo personduhet të paraqesë pranë sportelit të zyres me një ndalesë, sipas vendbanimit, çertifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile.

B.1.3.a.5. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifave të Sherbimeve Publike, ku përfshihen tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, dekorit dhe mirëmbajtja e varrezave publike, janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësitë Administrative sipas vendbanimit të Kryefamiljarit si dhe Agjenti Tatimor, i cili është caktuar Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Sh.A.Lezhë për Kryefamiljarët, që kanë kontratë furnizimi me ujë të pijshëm.

B.1.3.a.6. Lehtësirat / përjashtimet nga pagesa e tarifave për shërbimet publike :

Përjashtohen nga pagesa e Tarifave të Shërbimeve Publike:

a. Familjet,që kanë krye-familjarin invalid;
b. Familjet, që kanë në përbërjen e tyre, të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
c. Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike;
d. Pensionistët e vetëm ose me persona madhor të papunëose persona Invalid.
e. Gratë e dhunuara (Dokumenti verifikues "Udhër Mbrojtje", lëshuar nga Gjykata).
f. Gratë kryefamiljare me fëmijë deri në moshën 18 vjeç dhe ose deri në përfundimin e studimeve të larta (dokumenati verifikues : Çertifikatë familje dhe Vërtetim Shkolla përkatëse).
g. Familje të varfëra, me nivel ekonomik të ulët, por që arrijnë të plotësojnë kriteret për t'u trajtuar me ndihmë eknomike (Dokumenti verifikues: raporti social nga Administratori Social).
h. Nënat Beqare (dokumenti verifikues : Çertifikatë familjare).

Për të përfituar këto lehtësira fiskale, këto familje duhet të dorëzojnë tek Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, dokumentat e mëposhtëm:

a. Çertifikatën familjare,
b. Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit,
c. Librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit
d. Vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe dokumentacione te tjera qe vertetojne kushtet e mesiperme.

B.1.3.b. Kategoria e taksapaguesve "Biznes"

Në kategorinë biznes, hyn çdo subjekt, i cili është i regjistruar në QKB apo në organet tatimore si taksapagues, sipas llojit të aktivitetit, që ai ushtron.

B.1.3.b.1. Baza e tarifës, është llogaritur mbi koston e shërbimeve të ofruara në të gjithë territorin, i cili është nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

B.1.3.b.2. Niveli i Tarifës

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura sipas "**Aneksit Nr.4**", bashkëlidhur këtij vendimi.

B.1.3.b.3.Mënyra e pagesës:

Për kategorinë e taksapaguesve "Biznes", pagesa do të kryhet me dy këste, referuar tabelës sipas "**Aneksit Nr.4**", të cilat janë të përfshira në faturën për arkëtim, e cila llogaritet, hartohet dhe dërgohet me postë zyrtare nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Më pas subjekti me atë faturë mund të paraqitet pranë Institucioneve bankare, ku ai ka llogarinë apo Postës Shqiptare, për kryerjen e pagesës.

B.1.3.b.4. Detaje /sqarime

a. Në rastet e ushtrimit të aktiviteteve "Shërbim hoteleri turizëm, dhoma pushimi, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritje, turizëm familjar, etj te ngjashem me to", për përllogaritjen e tarifës së shërbimeve publike do tarifohen sipas vendndodhjeve të tyre, që janë brenda vijës bregdetare, të cituara në pikën "B.2.2", dhe sipas Njësive Adminstrative, që janë zonat "A"dhe "B", të cituara në pikën "I".

B.1.3.b.5. Afati i pagesës:

Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve "Biznes" është me dy këste të barabarta, brenda datës "30 qershor" dhe "30 Gusht" të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

Për kategorinë "Njësi Ndërtimi", nën kategoria "b", pika "b.1", dhe "b2", llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Lezhë të kërkesës për leje shfrytëzimi.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban ka detyrimin, që të informojë Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, çdo muaj, për numrin e Lejeve të Ndërtimit / Lejeve të Shfrytëzimit, të dhëna shoqëruar me emërtesat e subjekteve, me të dhënat identifikuese NIPT dhe adresë ku do kryhet ndërtimi si dhe numrin e kateve të objektit dhe sipërfaqen në metër katror në total, që do ndërtohet.

B.1.3.b.6. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifave të Shërbimeve Publike, për kategorinë "Biznes", është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.

B.1.b.7 Percaktime

a. Për të gjithë subjektet që aplikojnë për çregjistrim ose pezullim deri në datën 30 Qershor që është afati i fundit ligjor për shlyerjen e detyrimeve të subjekteve , ngarkesa për tarifat do të jetë përpjestimisht nga data 01 Janari deri në datën e aplikimit të cdo subjekti por me afat veprimi deri në 30 Qershor sipas përcaktimit të mësipërm, me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga

sektori i kontrollit pranë DTTV-së (kur subjekti ushtron aktivitet edhe pas aplikimit për çregjistrim), në rast të tillë ngarkesa do të jetë vjetore.

b. Për subjektet që aplikojnë për çregjistrim/pezullim pas datës 30 Qershor dhe nuk kanë paguar ende detyrimet vjetore ndaj Bashkisë, kur ka kaluar edhe afati ligjor i shlyerjes së detyrimeve ngarkesa për tarifat do të jetë vjetore.
Për të gjitha subjektet e reja ngarkesa për tarifat do të jetë nga data e hapjes së aktivitetit pranë QKB deri në fund të vitit fiskal.

c. Për bizneset e kategorive Biznes i Madh/Biznes i Vogël që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike si Shengjin, Tale, ngarkesa për taksën e pasurisë së paluajtshme, tabelës dhe reklamës do të jetë vjetore, ndërsa për tarifat nga data e riaktivizimit deri në fund të vitit fiskal me kusht që pezullimi të jetë bërë deri në fund të vitit paraardhës. Në të kundërt taksat dhe tarifat do të jenë vjetore.

d.Për subjektet e kategorisë "biznes i vogël/biznes i madh" të cilët për arsye objektive kryejnë veprime për mbyllje në QKB (aplikim për cregjistrim/pezullim) brenda muajit, ngarkesa për tarifat do të jetë vetëm për atë muaj pasi nuk kanë konsumuar ushtrimin e aktivitetit me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga sektori i kontrollit pranë DTTV-së (kur subjekti vazhdon të ushtrojë aktivitet edhe pas aplikimit për cregjistrim) ngarkesa do të jetë vjetore.

B.1.3.c. Kategoria e taksapaguesve "Institucione Shtetërore"

B.1.3.c.1. Baza e tarifës,

Është llogaritur mbi koston e shërbimeve të ofruara në të gjithë territorin, i cili është nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

B.1.3.c.2. Niveli i Tarifës

Nivelet treguese janë të shprehura në tabelën si më poshtë:

Nr	Emertimi i Tarifave	Njësia	Vlera
B.1.	Tarifat e Shërbimeve Publike (total)		300
1	Tarifa e Pastrimit	Leke / m^2 të sipërfaqes së ndërtesës	180
2	Tarifa e Gjelbërimit		54
3	Tarifa e Ndriçimit		56
4	Tarifa e Dekorit		10

B.1.3.c.3. Mënyra e pagesës:

Për kategorinë e taksapaguesve "Institucione Shtetërore", pagesa do të kryhet me dy këste, referuar tabelës së mësipërme, të cilat janë të përfshira në faturën për arkëtim, e cila llogaritet dhe hartohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

B.1.3.c.4. Afati i pagesës:

Afati i pagesës për kategorinë e taksapaguesve "Institucione Shtetërore", është me dy këste të barabarta, brenda datës "30 Qershor" dhe "30 Gusht " të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

B.1.3.c.5. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:
Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifave të Sherbimeve Publike, për kategorinë "Institucione Shtetërore" është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.

A - Perjashtohen nga Tarifat e Sherbimit Publik (Ndricim, Gjelbrim, Pastrim dhe Dekor) te gjithe subjektet e Tranportit Urban ne rastin kur ata sherbejne kategorine e Pensionisteve pa bilete transporti.

B- Lehtësohen nga tarifa e pastrimit, në masën 50%, bizneset e krijuara nga gra kryefamiljare që kanë tre ose më shumë fëmijë, vetëm pas dorëzimit të certifikatës familjare dhe ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

C- Përjashtohen nga tarifa e pastrimit shoqatat e themeluara nga pensionistë ose persona me aftësi të kufizuara. Për të përfituar nga ky përjashtim, përfaqësuesi juridik i shoqatës depoziton pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vendimin e regjistrimit përkatës.

B.2. Tarifa për Shfrytëzim të Hapësirave Publike

B.2.1. Përkufizimi
Hapësirë publike konsiderohet çdo pasuri e llojit Truall, e cila nuk figuron e regjistruar në emër të individit apo biznesit dhe është lëhtësisht e përdorueshme nga çdo qytetar apo vizitor.

B.2.2. Baza e Tarifës për Shfrytëzim të Hapësirave Publike
Është sipërfaqja në metër katror, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Detyrimi i tarifës përllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit. Kategoritë dhe nënkategoritë e tarifës për Shfrytëzimin e hapësirave publike, sipas zonave të ndara sipas pikës II, të këtij vendimi, jepen si në tabelën e mëposhtëme:

Nr.	Kategoria	Njësia	Niveli i Tarifes	
			Zona A	Zona B
1	Organizimin e spektakleve ose panaireve	Lekë/m2/ditë	300	300

2	Shfrytëzimin e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	Lekë/m2/muaj	600	350
3	Shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin kryesor "Gjergj Kastrioti".	Lekë/m2/Ditë	200	
4	Shfrytëzimin e hapësirave publike në zonat e plazhit			
a	Zona 1	Lekë/m2/Sezon	600	
	Zona 1	Lekë/cader/Sezon	6,000	
b	Zona 2	Lekë/m2/Sezon	400	
	Zona 2	Lekë/cader/Sezon	4,000	
c	Zona 2 – Zona sherbime organizative sociale kulturore sportive e te ngjashme	Lekë/m2/muaj	100 leke kur perdoret per qellime perfitimi ekonomik	
			0 leke kur behet marreveshje me kerkese ne Bashki	
d	Shfrytezim i hapsires per vendbazim ose lojra rekreative ujore	Lekë/m2/Sezon	600	

Kufizimet e zonave të cituara në pikën 4, janë si më poshtë:

- Zona 1, Plazhet në Shëngjin, në veri nga Rera e Hedhur deri në jug tek Gryka e Merxhanit.
- Zona 2, Plazhet në Vain dhe Plazhet në Tale.

B.2.3. Dhënia e Lejes për Shfrytëzimin e Hapësirës Publike

Në të gjitha rastet e përdorimit të hapësirës publike, për të gjithë pikat e cituara në tabelën e mësipërme, subjekti duhet t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me kërkesë për t'u paisur me Leje "Për shfrytëzim të hapësirës publike". Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi nëse kjo sipërfaqe, që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti, ploteson kriteret për dhënie për shfrytëzim për qëllimet e cituara në tabelën përkatese, për biznes apo aktivitete të tjera dhe më pas kryen matjen në terren të sipërfaqes së kërkuar për shfrytëzim të hapësirës publike. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Planifikikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, lidhur me sipërfaqen në metër katror të hapësirës publike, që do jepet me qera, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës, sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, struktura përgjegjëse për dhënien e "Lejes për Shfrytëzim të Hapësirës Publike", për pikat "1", "2" dhe "3" subjektit përkatës, sipas "Aneksit nr.6", bashkëlidhur këtij vendimi.

Në rastet e aplikimit për leje, *sipas përshkrimit të pikës 3, hapësira publike* në sheshin"Gjergj Kastrioti", leja jepet vetëm në rastet e organizimit të aktiviteteve të tilla madhore, të cilat japin impaktin e duhur pozitiv në përshtatje me Planin Strategjik të Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Lezhë.

B.2.4. Afati i pagesës

Paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar dhe konfirmuar kryerja e plotë e pagesës, sipas formatit të lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

B.2.5. Strukturat përgjegjësetë hartimit të faturës dhe vjeljes së tarifës

Strukturë përgjegjëse për hartimin e faturës, sipas informacionit zyrtar të marrë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban si dhe për vjeljen e Tarifës për "Shfrytëzimin e Hapësirave publike për qëllime Biznesi", është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në faturën për arkëtim, krahas detyrimit për tarifën e shfrytëzimit të hapësirës publike, përfshin paralelisht edhe detyrimet vjetore dhe të prapambetura për tarifat e Shërbimeve Publike për pastrim, gjelbërim, ndriçim dhe dekor, për subjektin.

B.2.6. Strukturat Përgjegjëse të Monitorimit të Zbatimit të Kontratës

Për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të kontratës së lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike, janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, IVMT dhe Policia e Bashkisë. Nëse gjatë ushtrimit të kontrolleve të përditshme në terren, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohen raste të shfrytëzimit të hapësirave publike mbi sipërfaqen e caktuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë si dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike pa Leje dhe pa Kontratë, të lidhur me Bashkinë Lezhë, në të dyja rastet, inspektorët e kontrollit dhe verifikimit në terren, kane detyrim mbajtjen e akt konstatimit për çdo rast, matjen e sipërfaqes së cituar më lart dhe vendosjen e penaliteteve përkatëse. Ky akt konstatimi, i mbajtur nga inspektorët e Kontrollit dhe Verifikimit në Terren, kalon për vlerësim tatimor Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me nivelin e tarifave të cituar në tabelën përkatëse të tarifave për shfrytëzimin e hapësirave publike, për sa kohë, që ajo sipërfaqe vazhdon të shfrytëzohet nga subjekti. Krahas kësaj procedure, hartohet dhe shkresën përkatëse për informacion për shfrytëzim të sipërfaqes së hapësirës publike, pa Lejen përkatëse nga Bashkia, për Drejtorine e IVMT dhe atë të Policisë së Bashkisë, të cilat ndjekin procedurat e tjera, konform ligjit.

B.3. Tarifa e Parkimit të Automjeteve

B.3.1. Përkufizimi

Zonat, sheshet dhe rrugët e lejuara për parkim, për t'u përdorur nga qytetarët, me dhe pa pagesë do jenë konform standarteve dhe legjislacionit përkatës në fushën e qarkullimit rrugor. Është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për përcaktimin e zonave, rrugëve dhe shesheve, që mund dhe do të përdoren nga të tretët për qëllime parkimi, hartimin e projekt vendimit dhe paraqitjen në Këshillin e Bashkisë për miratim si dhe më pas respektimin e standarteve në kryerjen e vijëzimit dhe vendosjen e tabelave, për të gjithë vendet e parkimit në çdo lagje dhe rrugë.

B.3.2. Niveli i Tarifës

Tarifa e shfrytëzimit të hapësirave për qëllime parkimi, për zonat, sheshet dhe rrugët e miratuara nga

Këshilli i Bashkisë të lejuara për parkim, për t'u përdorur nga qytetarët dhe bizneset, me pagesë, për të cilët do aplikohet kjo tarifë, do jetë sipas ndarjeve si më poshtë :

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli I tarifës së parkimit		
			Tarifa për parkim me pagese me tra	Vend Parkim i Rezervuar (vija Verdhë)	Vend parkime të miratuara si Stacione Qëndrimi
1.	Autobuzat e linjave ndërqytetëse e rrethqytetse	Lekë/ vit			**30.000**
2.	Autovetura Taksi	Lekë/ vit			**15.000**
3.	Automjete për transport mallrash	Lekë/ vit			**35.000**
4.	Autovetura	Lekë/ vit		**72.000**	
5.	Autovetura 0-1 orë	Lekë	**100**		
6.	Autovetura 1-3 orë	Lekë	**200**		
7.	Autovetura 3-8 orë	Lekë	**300**		
8.	Autovetura 24 orë	Leke/ditë	**700**		
9.	Autobuz/ kamionçinë	Lekë/orë	**100**		
10.	Abono mujore per adminstraten e Bashkise	Leke/Muaj	**1500**		
11.	Abone mujore per te tjerë.	Leke /Muaj	**3000**		

Tarifa e cituar në pikën 3.2., pika 10" dhe 11", paguhet paradhënie, e plotë për të gjithë periudhën, që punonjësi/individi ka bërë kërkesën për abonim.

B.3.3.Përjashtimet :
Përjashtohen nga tarifa e parkimit te automjeteve, rezidentët, që janë brenda traut të parkimit të automjeteve në sheshin Gjergj Kastrioti" si dhe invalidët tetraplegjikë me drejtues mjeti tjetër ose me makinë të përshtatur.

B.3.4. Dhënia e Lejes për Parkim
Në të gjitha rastet e kërkesës sëpërdorimit të hapësirës publike për qëllime parkimi të rezervuar për automjete, të çfarëdo lloji qofshin ato, subjekti duhet të drejtohet me shkrim tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit,në Bashkinë Lezhë, me kërkesë për t'u paisur me Leje "Për shfrytëzim të Hapësirës Publike për Qëllime Parkimi të Rezervuar". Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi, nëse kjo sipërfaqe, që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti është pjesë e hapësirave publike të miratuara më parë nga Këshilli Bashkiak, për dhënie për shfrytëzim për qëllime parkimi të rezervuar ose ditore. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon

me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialisti i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, juristi pranë Drejtorisë së Sherbimeve harton kontraten për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes për parkim subjektit, sipas "Aneksit nr.7", bashkëlidhur këtij vendimi; vijëzimit dhe vendosjes së sinjalistikës vertikale.

B.3.5. Afati i pagesës

Për kërkesat e reja, pagesa kryhet paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar kryerja e pagesës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, sipas kontratës së firmosur nga palët. Për lejet "Për shfrytëzim të Hapësirës Publike për Qëllime Parkimi të Rezervuar", të lëshuara një vit më parë, në qytetin e Lezhës, afati i pagesës është 28 Shkurti. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, brenda muajit janar ka detyrimin për dërgimin e faturës te këto biznese. Brenda datës 15 Mars, kjo drejtori, duhet të marrë masa për heqjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, te subjektet që nuk kanë kryer akoma pagesë apo nuk kanë lidhur kontratën për "Për shfrytëzim të Hapësirës Publike për Qëllime Parkimi të Rezervuar", për vitin në vazhdim. Në qytetin e Shëngjinit afati i dërgimit të faturave është 15 maji, kurse afati i pagesave nga ana e subjekteve është 31 maji. Deri me 15 qershor Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastruktures, Transportit dhe Mjedisit, duhet të marrë masa për heqjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontal, të subjektet që nuk kanë kryer akoma pagesë apo nuk kanë lidhur akoma kontratën për "Për shfrytezim të Hapsirës Publike për Qëllime të Rezervuar" , për vitin në vazhdim.

B.3.6. Strukturat përgjegjëse të hartimit të faturës, vjeljes së tarifës dhe Verifikimit të Pagesës

Strukturë përgjegjëse për përgatitjen, lëshimin e faturës dhe vjeljen e Tarifës dhe Verifikimit të Pagesës, për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike, për "Vend Parkim i Miratuar me Pagesë (Vija Blu)", "Vend Parkim i Rezervuar (Vija e Verdhë)" dhe "Vend Parkime të Miratuara si Stacione Qëndrimi", për të gjithë automjetet e transportit rrugor, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, në Bashkinë Lezhë.

B.3.7. Strukturat përgjegjëse të Monitorimit të Zbatimit të Kontratës

Për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të kontratës së lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike, janë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, dhe Policia e Bashkisë

B.3.8. E drejta për kërkesës për leje

Subjektet e biznesit përson fizik, mund të bëjnë kërkesë për t'u paisur me Leje Shfrytëzimi Hapësire publike për qëllime parkimi të rezervuar, vetëm për një vendparkim, ndërsa subjektet e biznesit përson juridik, jo më shumë se dy vende parkimi. Periudha e kohëzgjatjes së kontratave, për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendparkimet e rezervuara, nuk mund të jetë më e shkurtër se 6 muaj. Parkimet e rezervuara për autoveturat 4+1, ofrohen vetëm për kategorinë e taksapaguesve "Biznes" dhe "Institucione Shtetërore". Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, ka përgjegjësi për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale për përcaktimin e vendit të parkimit, ndërsa shpenzimet për mbulimin e kostos për elementët e tjerë të përdorshëm, si ikonat birilat etj, mbulohen nga vetë biznesi, të prodhuara sipas formatit, formës e ngjyrës, të propozuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit

dhe të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë.

B.4.Tarifa e shërbimit furnerale

B.4.1. Përkufizimi

Tarifa e shërbimit funeral është pagesa që kryhet nga indivitët ose familjarët e personit të ndjerë, për të mbuluar kostot që lidhen me kryerjen e shërbimit të plotë të varrimit në varrezat publike të qytetit Lezhë, konkretisht varrezat në lagjen Nënë Tereza, Grykë Zezë dhe në Gocaj.

B.4.2. Subjekt i tarifës

Individët, familjarët apo përfaqësuesit ligjor që kërkojnë të kryejnë varrimin në varrezat publike të qytetit Lezhë.

B.4.3. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është si më poshtë :

	Tarifa e shërbimit funeral		
1	Tarifa e shërbimit funeral	Lekë / për varrim	**25.000**

B.4.4. Baza e tarifës

Bazë për llogatirjen e e nivelit të tarifës së shërbimit funeral është numri i varrimeve të kryera, Njësia matëse :1 varr/ 1 varrim.

B.4.5. Strukturë përgjegjëse

Strukturë përgjegjëse për llogaritjen e tarifës së shërbimit funeral do te jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit e Bashkisë Lezhë.

B.4.6. Mënyra e pagesës dhe e vjeljes se tarifës

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit lëshon urdhërin e pagesës për tarifën e shërbimit funeral.

Pagesa kryhet nga individi ose familjari i personit të ndjerë para marrjes së çertifikatës së vdekjes. Pas kryerjes së pagesës, individi pajiset me vertetim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, i cili e paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile për të lëshuar çertifikatën e vdekjes.

B.5. Tarifat për Çertifikimin dhe Licencimin e Transportit të Udhëtarëve & Mallrave.

B.5.1. Përkufizimi

Çertifikata dhe Liçencat janë dokumente vërtetues të llojit të aktivitetit të subjektit, të cilat lëshohen nga Bashkia Lezhë

B.5.2. Niveli e Tarifës

Niveli i tarifave është në tabelën si më poshtë :

Nr	Emërtimet e Çertifikatave / Liçencave	Njësia	Niveli i Tarifës
A	**Për Transportin e Udhëtarëve**		

1	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/ 10 vjet	**80.000**
2	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rreth qytetëse		**40.000**
3	Licensë për agjensi transport udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë / 5 vjet	**15.000**
4	Licensë për agjensi ndërkombëtare për transport udhëtarësh		**40.000**
5	Licensë për transport udhëtarësh me taksi brenda vendit		**20.000**
6	Licensë për shërbim të rregullt të specializuar në transportin e udhëtarëve.		
7	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Lekë / mjet / vit	**1.000**
8	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse		**1.500**
9	Çertifikatë për shërbim të rregullt të specializuar në transportin e udhëtarëve	Lekë / mjet / vit	**1.500**
10	Çertifikatë për transportin e udhëtarëve për llogari të vet.	Lekë / mjet / vit	**1.500**
11	Libër udhëtimi për shërbimet e rastit në transportin e udhëtarëve	Lekë / bllok	**5.000**
B	**Për Transportin e Mallrave**		
1	Licensë për transport mallrash, për të tretë dhe me qera, brenda vendit.	Lekë / 5 vjet	**40.000**
2	Çertifikatë për transport mallrash, për të tretë dhe me qera, brenda vendit.	Lekë /ton /vit	**100**
3	Çertifikatë për transport mallrash, për llogari të vet, brenda vendit.		

B.5.3. Baza e tarifës

Niveli i Tarifave është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi dhe Udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15, date 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar, Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar.

B.5.4. Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve, faturimin dhe vjeljen e tarifës

Për hartimin e kritereve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për t'u paisur me Çertifikatën dhe Liçencën, sipas kërkesës së tyre, konform ligjit dhe VKM përkatëse, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialisti i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, lidhur me llojin e Çertifikatës apo Liçencës. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, e cila, plotëson Liçencën / Çertifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar dhe të konfirmuar

për pagesën nga kjo Drejtori ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Jurdike. Më pas formati i Licencës / Certifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Licencës / Certifikatës subjektit, respektivisht sipas **"Anekseve nr.8" dhe "Anekseve nr.9",** bashkëlidhur këtij vendimi.

B.6.Tarifa për Dhënien e Licencave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhë Lëndëve Djegëse për Përdorim nga Konsumatorët Fundorë.

B.6.1. Baza e Tarifës:

Niveli i Tarifave është i përcaktuar sipas VKM nr.970, datë 02.12.2015. i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

B.6.2. Niveli i tarifës

Niveli është sipas kategorive si më pshtë :

Nr	Kategoria / zëri shërbimit	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante.	Lekë / Licencë / 5 vjet	**1.000.000**
2	Për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë		**100.000**

B.6.3. Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe vjeljen e tarifës

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, është përgjegjëse për hartimin e kritereve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për t'u paisur me Certifikatën dhe Licencën, sipas kërkesës së tyre bazuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialist i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, e cila, plotëson Licencën / Certifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar dhe të konfirmuar për pagesën nga kjo Drejtori ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Jurdike. Më pas formati i Licencës / Certifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Licencës / Certifikatës subjektit, **sipas "Aneksit nr.10",** bashkëlidhur këtij vendimi.

B.7 Tarifa për licencë për agjencitë furnerale

B.7.1. Përkufizimi

Të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimit funeral, bazuar në ligjin nr.9220,

datë 15.04.2014 " Për administrimin e shërbimit të varrimit' , i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 711, datë 29.10.2014, i ndryshuar duhet të pajisen me licensë për agjenci funerale.
Agjencitë dhe shtëpitë funerale duhet të zhvillojnë aktivitetin, si plotësimi i formaliteteve, shitja e artikujve të varrimit dhe çdo aktivitet tjetër brenda ambjenteve të miratuara dhe që janë jo të dukshme nga jashtë.

B.7.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është si më poshtë :

	Licensë për agjenci për shërbimin funeral		
1	Licencë për agjenci për shërbimin funeral	Lekë / 5vjet	**50.000**

B.7.3. Baza e tarifës

Bazë për llogatirjen e licensë për shërbimin funeral do jetë subjekti i cili ushtron aktivitet në fushën e shërbimin funeral, pavarësisht nga numri i vendndodhjeve që ka të regjistruar në QKB.

B.7.4. Strukturë përgjegjëse

Strukturë përgjegjëse për llogaritjen e Licences për agjencite e shërbimit funeral do te jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit e Bashkisë Lezhë.

B.7.5. Afati i pagesës

Detyrimi për Licence për agjencitë e shërbimit funeral është 5 vjeçar. Afati i pagesës për vitin e parë të pajisjes me liçencë për subjektet ekzistuese është deri në datën 30 Mars 2027, për subjektet e reja 30 ditë pas rregjistrimit në QKB.

B.7.6 Tarifa për çertifikate për agjensite/shtëpitë e shërbimit funeral.

B.7.1. Përkufizimi

Të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimit funeral, pajisen me nje Licenc7 të vetme për ushtrimin e aktivitetit të sherbimit funeral, pavarësisht nga numri i vendodhjeve. Në çdo vendodhje ku subjekti ushtron aktivitetin, ai është i detyruar të pajisen me çertifikate vjetore të ushtrimit të veprimtarisë për agjenci/shtëpi të sherbimit funeral.

B.7.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është si më poshtë :

	Licensë për agjenci për shërbimin funeral		
1	Tarifë për çertifikaten për agjenci/shtëpi për sherbimin funeral	Lekë / vit	**10.000**

B.7.3. Baza e tarifës

Bazë për llogatitjen e tarifes për çertifikaten për agjenci/shtëpi për sherbimin funeral do jetë subjekti I cili ushtron aktivitet në fushen e sherbimit funeral, për çdo vëndndodhje që ka të regjistruar në QKB.

B.7.4. Strukturë përgjegjëse

Strukturë përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e tarifes për çertifikaten për agjenci/shtëpi për sherbimin

funeral, do te jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit e Bashkisë Lezhë.

B.7.5. Afati i pagesës

Detyrimi e tarifes për çertifikaten për agjenci/shtëpi për sherbimin funeral është 1-vjeçar. Afati i pagesës për vitin e parë të pajisjes me licencë për subjektet ekzistuese është deri në datën 30 Mars 2027, për subjektet e reja 30 ditë pas rregjistrimit në QKB.

B.8. Tarifat e Shërbimeve nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit & Zhvillimit Urban

B.8.1. Përkufizimi

Këto tarifa aplikohen në rastet kurbanorët / subjektet aplikojnë në Bashki për çështje, që lidhen me shërbimet e ofruara nga kjo Drejtori.

B.8.2. Niveli i Tarifës

Niveli është sipas kategorise si më poshtë :

Nr	Emertimet/ Zerat e Sherbimeve	Njesia	Niveli i Tarifes
1	a. Kërkesë për leje zhvillimi - ndertimi për nevoja biznesi	Lekë/aplikim	10.000
	b. Kërkesë për leje zhvillimi - ndertimi për shtepi banimi/familjare	Lekë/aplikim	2.000
	c. Kërkesë për leje ndryshim funksioni	Lekë/aplikim	Sa 50% e vlerës së TNI sipas funksionit të propozuar, por jo më pak se 5'000 lekë
	d. Kërkesë për ndryshim subjekti ndertues/zhvillues	Lekë/aplikim	5.000
	e. Kërkesë për shtyrje afati të lejes	Lekë/aplikim	5.000
	f. Kërkesë për certifikate përdorimi	Lekë/aplikim	5.000
	g. Kërkesë për leje infrastrukture	Lekë/aplikim	10.000
	h. Kërkesë për deklarate paraprake për punime sipas nenit 7 të VKM 408.	Lekë/aplikim	10'000
	i. Kërkesë për punime mirëmbajtje sipas nenit 6 dhe 6/1 të VKM 408.	Lekë/aplikim	7'000
2	Njehsim i dokumenteve me origjinalin	Lekë/flete	100
3	a. Akt kontrolli Nr.1: Ngritja e kantierit të punimeve, përfshire rrethimin.	Leke/kontroll	10.000
	b. Akt kontrolli Nr.2: Piketimi i struktures	Leke/kontroll	10.000
	c. Akt kontrolli Nr.3: Përfundimi i themeleve dhe kuota +/-0.00	Leke/kontroll	10.000
	d. Akt kontrolli Nr.4: Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin.	Lekë/kat/kontroll	10.000
	e. Akt kontrolli Nr.5: Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik.	Lekë/kontroll	10.000

	f. Akt kontrolli Nr.6: Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese.	Leke/kontroll	10.000
4	a. Akt kontrolli Nr.1: Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë rrethimin, për objekte sipër 250 m2.	Lekë/kontroll	25.000
	b. Akt kontrolli Nr.2: Piketimi i strukturës	Lekë/kontroll	25.000
	c. Akt kontrolli Nr.3: Përfundimi i themeleve dhe kuota +/-0.00, për objekte sipër 250 m2	Lekë/kontroll	25.000
	d. Akt kontrolli Nr.4: Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin, për objekte sipër 250 m2.	Lekë/kat/kontroll	25.000
	e. Akt kontrolli Nr.5: Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik, për objekte sipër 250 m2.	Lekë/kontroll	25.000
	f. Akt kontrolli Nr.6: Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese.	Lekë/kontroll	25.000
5	Azhornime për leje ndertimi, reklama, zenie hapesirash publike.	Lekë/dokument	5.000
6	Matje e percaktim i zones së vendndodhjes se objektit,	Leke/dokument	3.000

B.8.3. Struktura përgjegjëse për hartimin e faturës për arkëtim dhe vjeljen e tarifës

Për Shërbimet e kryera, sipas zërave të shërbimeve të cituara në tabelën e mësipërme, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

B.8.4. Mënyra e pagesës:

Menyra e pageses: Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, për çdo rast të ofrimit të sherbimit sipas zerave të cituara në tabelen e mësiperme, harton faturen përkatese me emertesen e zerit të sherbimit, nivelin e tarifes për atë zë sherbimi dhe vleren e plotë, që del si rezultat i aplikimit të kësaj tarife. Pas marrjen së fatures është detyrim i subjektit të kryeje veprimin e pageses në Banke/ Arken e Bashkisë. Pas verifikimit të kryerjes së pageses nga ana e subjektit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, vazhdon proceduren për ofrimin e sherbimit të kërkuar

B.9. Tarifa për shfrytëzim të ambjenteve të Institucioneve vartëse

B.9.1. Përkufizimi

Drejtuesit e Institucioneve vartëse të Bashkisë Lezhë, kanë të drejtë të japin në përdorim ditor ose për një periudhë më të gjatë kohe për shfrytëzim nga të tretët për përdorim të ambjenteve të brendshme të tyre, gjithmonë pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë apo personit të autorizuar, kundrejt tarifave përkatëse si më poshtë :

B.9.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategoritë / Emërtimet e Ambjenteve	Njësia	Niveli i tarifës
A	**Pallati i Kulturës**		
1	Salla e Leksioneve / Mbledhjeve	Lekë/ përdorim	**15.000**
2	**Salla e Madhe e Shfaqjeve**		
a	Për të Rritur	Lekë/orë/ përdorimi	**15.000**
b	Për Fëmijë		**0**
c	Për rastet kur organizuese e aktivitetit është Bashkia		**0**
3	**Salla e Galerisë së Arteve**		
a	Për ekspozita	Lekë/ditë/ përdorimi	**5.000**
b	Për piktorët e rinj		**0**
B	**Biblioteka e qytetit**		
a	Holli në katin e dytë	Lekë/ditë/ përdorimi	**7.000**
b	Holli në katin e tretë (Salla Fishta)		**3.000**
c	Hapje kartele lexuesi të rregullt	Lekë/kartelë/vit	**100**
d	Hapje kartele lexuesi për fëmijët		**0**
C	**Muzeu & Memoriali**		
a	Biletë hyrje vizitorësh për të rritur	Lekë / biletë	**200**
b	Biletë hyrje vizitorësh për fëmijë deri 13 vjeç, përfshirë këtë moshë		**0**
D	**Muzeu Arkeologjik në Kala**		
a	Biletë hyrje vizitorësh për të rritur	Lekë / biletë	**200**
b	Biletë hyrje vizitorësh për fëmijë deri 13 vjeç, përfshirë këtë moshë		**0**
E	**Klubi Sportiv Besëlidhja**		
a	Për shfrytëzim të ambjenteve sportive	Lekë/aktivitet	**50.000**
b	Biletë hyrëse në Stadium		
b.1	Në Tribunë	Lekë / Biletë	**200**
b.2	Jashtë Tribunës		**100**
F	Qendra Kulturore e Fëmijëve		
a	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë / Orë përdorimi	**10.000**
b	Salla e vogël		**5.000**

B.9.3. Strukturat përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe vjeljen e tarifave:

Institucionet vartëse, janë përgjegjëse për hartimin e kritereve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për të marrë në shfrytëzim ambjentet, që janë nën administrimin e tyre. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit,e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Institucioni përkatës, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Finances dhe Buxhetit dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, procedura vazhdon përsëri tek Institucioni, i cili plotëson Lejen e kërkuar, sipas formatit ligjor, të konceptuar nga Institucioni përkatës dhe konfirmuar për pagesën e kryer të subjektit nga Drejtoria Finances dhe Buxhetit, ndërsa për bazueshmërinë ligjore nga Drejtoria Juridike, sipas formatit të miratuar. Në fund fare, janë Institucionet vartëse, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes për Shfrytëzim të Ambjenteve të Institucioneve Vartëse", në të cilën specifikohet qartë emri i subjektit, lloji i aktivitetit, që do të zhvillohet, data / ora e zhvillimit dhe kohëzgjatja, sipas **"Aneksit nr.11", bashkëlidhur këtij vendimi.**

B.9.4. Perjashtimet

Përjashtohen nga pagesa e tarifës së përdorimit të ambienteve kulturore në administrim të Drejtorisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore, kategoritë e mëposhtme:

a) Aktivitetet kulturore, artistike, edukative dhe përkujtimore të organizuara nga Bashkia Lezhë dhe institucionet në varësi të saj.
b) Aktivitetet e organizuara nga institucionet arsimore publike, me karakter edukativ, kulturor dhe artistik, pa qëllim fitimi.
c) Aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, në kuadër të marrëveshjeve institucionale.
d) Aktivitetet me karakter humanitar, social dhe komunitar, pa qëllim fitimi, të miratuara paraprakisht nga Bashkia Lezhë.
e) Aktivitete të tjera me interes publik, për të cilat përjashtimi nga tarifa miratohet paraprakisht nga Bashkia Lezhë, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Paketën Fiskale në fuqi.

B.10. Tarifa për shërbimin akomodimit dhe ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve, në Kopështe dhe Çerdheve.

B.10.1. Përkufizimi

Në shërbimin e akomodimit dhe ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve, futen të gjithë ato që regjistrojnë fëmijët në Kopështe dhe Çerdhe.

B.10.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategoria e shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Akomodim në Kopështe	Lekë / muaj	220 lekë / ditë
2	Akomodim në Cerdhe	Lekë / muaj	E barabarte me koston e ushqimit te ofruar

B.10.3. Baza e tarifës

Për shërbimin e ofruar do jetë kostoja në **220** lekë/ditë qëndrimi për çdo fëmijë ne kopshte dhe e barabarte me koston e ushqimit te ofruar ne çerdhe , kosto e cila përfshin vetëm shpenzimet për ushqimin e fëmijëve, i cili është regjistruar në atë Njësi Shërbimi.

B.10.4. Strukturë përgjegjëse

Për llogaritjen e kostos dhe përgatitjen e formatit të faturës për arkëtim të nivelit të "Tarifës për Ofrimin e Shërbimit të Qëndrimit në Kopësht / Çerdhe", janë Drejtoria Finances dhe Buxhetit / Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Sherbimit dhe Kujdesit Social. Për vjeljen e tarifës, Drejtoria përkatëse sipas informacionit të marrë nga Institucioni i Kopështit/Cerdhes së qytetit për numrin e fëmijëve të akomoduar gjatë muajit, harton faturën për arkëtim për çdo kryefamiljar.

B.10.5. Afati i pagesës

Për kryerjen e pagesës për regjistrimin në Kopësht, kryefamiljarët janë të detyruar të bëjnë një pagesë paradhënie, në vlerën e shpenzimeve mujore 4840 lekë.

Për kryerjen e pagesës për regjistrimin në Cerdhe , kryefamiljarët janë të detyruar të bëjnë një pagesë paradhënie, në vlerën e shpenzimeve mujore te nje muaji me pare por jo me pak se 2 500 lekë. Më pas ato faturohen sipas kostos mujore nga Drejtoritë përkatëse të sipërcituara, duke respektuar afatin jo më vonë se 10 ditë nga muaji pasardhës. Pagesa e parë paradhënie do të konsiderohet si pagesë e muajit të fundit.

B.10.6. Lehtësirat fiskale

Do përfitojnë një zbritje në masën 100% të tarifës nga pagesa për Tarifën e shërbimit të akomodimit dhe ushqimit ndaj fëmijëve, në Njësitë e Shërbimit në Çerdhe e Kopështe, kategoritë e mëposhtme :

a. Familjet, që kanë krye-familjarin invalid,
b. Familjet, që kanë në përbërjen e tyre, të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
c. Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike,
d. Familjet e komunitetit Rom.
e. Gra të veja
f. Nënat beqare të cilat kanë femijë frekuentues në cerdhe ose kopshte në datën e miratimit të paketës fiskale.

Për të përfituar këto lehtësira fiskale, duhet të dorëzojnë Pranë Bashkisë Lezhë, dokumentat e mëposhtëm:

e. Çertifikatën familjare,
f. Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit,
g. Librezën për paraplegjik e tetraplegjik.
h. Vërtetimin për përfituesit e ndihmës ekonomike.
i. Dokumentacion tjeter qe verteton kushtet e mesiperme.

B.11. Tarifa për përdorimin e mjeteve të lundrimit

B.11.1. Përkufizimi

Tarifa për përdorimin e mjeteve në lundrim do të aplikohet mbi të gjithë subjektet që përdorin mjetet lundruese për qëllim biznesi.

B.11.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Kategoria e shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	**Tarifa për përdorimin e**	Lekë /vit	20.000 lekë/vit

	mjeteve te lundrimit		

B.11.3. Afati i pagesës
Kjo taksë do të faturohet 1 herë në vit dhe do të likujdohet sipas afateve të paracaktuara në ketë dokument për të gjitha taksat vjetore.

B.11.4. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :
Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

B.112. Tarifa për linjat infrastrukturore në prone publike.

B.12.1. Përkufizimi
Tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore për qellime biznesi, si: tubacione, kanale, linja ajrore etj., të cilat janë ndërtuar në pronë publike.

B.12.2. Niveli i tarifës
Niveli i tarifës është sipas kategorive si më poshtë :
Tarife për linja infrastrukture (telefoni, energji, gaz, tv kabllor, ujësjelles)

Nr.	Kategoria	Njësia	Niveli Tarifes
1	Për linjat ajrore	Lekë/km/vit	5.000
2	Për linjat nëntokësore	Lekë/km/vit	3.000

B.12.3. Baza e tarifës
Baza e tarifes për linjat nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e tarifës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

B.12.4. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :
Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifes është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Lezhë.

B.12.5. Mënyra e pagesës:
Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, njofton subjektet të cilat disponojnë leje infrastrukture për deklarimin e linjave që shfrytëzojnë bashkë me harten përkatese të vendndodhjes së linjave dhe mbi këtë bazë hartohet fatura e tarifes.
Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban të dhënat e deklaruara nga subjektet mbi linjat në përdorim ja dërgon Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake për verifikim.

C. ANKIMIMI

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyren se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga

strukturat e Drejtorive përkatëse në Bashkinë Lezhë.

Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin administrativ, dhe përmban:

a) emrin, adresen dhe NIPT-in e apeluesit;
b) vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi;
c) natyren dhe shumën e tatimit ose gjobës, që është subjekt apelimi;
d) baza ku mbështetet apelimi.

1.Ankimi nuk shqyrtohet nëse subjekti nuk ka dorëzuar deklarimin e pronës ose dokumentacionin që vërteton pronësinë (certifikatë pronësie / kontratë qiraje / akt përdorimi), sipas nenit 21 të Ligjit nr. 9632/2006 dhe nenit 108 të Ligjit nr. 9920/2008."
Në mungesë të këtij dokumenti, ankimi nuk merret në shqyrtim."
Dhe në dosjen e ankimimit, sektori i verifikimit vendos shënimin:
"Refuzohet për mungesë të deklarimit të pasurisë sipas Ligjit nr. 9632/2006, neni 21."

2.Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit, për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrativ.

3.Proçedurat e apelimit dhe proçedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar, neni 7, nëLigjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të tij.

4.Sektori i Apelimit Tatimor, shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Kundër vendimit të Sektorit të Apelimit, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijeni për vendimin e mësipërm.

D. Penalitetet / Gjobat

D.1. Përkufizimi

Për çdo rast të moszbatimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, ndaj çdo kundravajtësi do ketë penalitete, sipas kategorisë dhe shkeljes si më poshtë :

D.2. Niveli i Penalitetit / Gjobës

Niveli është sipas kategorive si më poshtë :

Nr	Emërtimi / Përshkrimi i shkeljes	Njësia	Niveli i Gjobës / Penalitetit / Taksapagues	
			Familjarë	Biznes
1	**Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore**			
a	Bllokim rruge & trotuari, si rrethim me material ndërtimi, etj të ngjshme me to.	Lekë/rast	**5.000**	**20.000**
b	Dëmtim / çarje të rrugës apo trotuarit.		**10.000**	
c	Ndotje të rrugës apo trotuarit.		**5.000**	
ç	Dëmtim të pasijeve / materialeve të instaluara në rrugë / sheshe.		**10.000**	
d	Përdorimi I hapësirës ajrore në shtylla ndricimi etj, për suport për lidhjen e kabllove të internetit.		**20.000**	

e	Dëmtime në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha / zeza.		**5.000**	
2	**Mosrespektim i rregullave për Shërbimet Publike**			
a	Hedhja e mbetjeve jashte orarit te caktuar	Lekë/rast	**10.000**	**20.000**
b	Hedhja e mbetjeve jashte pikave te grumbullimit te miratuara nga Bashkia.		**10.000**	
